

INFORMATAT THEMELORE PËR PROJEKTIN EU-RRK V

Emri i donatorit:	Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë (EUOK) dhe bashkë-financuar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim
Emri i programit:	EU Kthimi dhe Ri-integrimi në Kosovë faza V (EU-RRK V)
Numri i familjeve që do të asistohen:	Deri në 400 familje
Kohëzgjatja:	42 muaj
Statusi i Programit:	Propozimi i aprovuar – Data e fillimit 10 nëntor 2017
Lokacioni:	Fondet e EU-së Komunitatet e Kosovës, Pejë, Klinë, Istog, Obiliq, Fushë Kosovë, Graçanicë, Novobërdë, Kamenicë, Shtërpçë, Prizren dhe Rahovec. Fondet e MKK-së: Të gjitha komunitetet e Kosovës do të konsiderohen në bazë të nevojës dhe interesit të tyre të vërtetë për kthimin e personave të zhvendosur.
Qëllimi:	Ky veprim do të kontribuojë në një shoqëri multietnike stabile në Kosovë duke mundësuar kushte jetësore të qëndrueshme dhe integrim të qëndrueshëm të personave të zhvendosur në shoqërinë kosovare, duke përfshirë Personat e Zhvendosur Brenda Vëndit (PZhbV), Personat e Zhvendosur në Rajon (PZhr) dhe refugjatët siç përcaktohet sipas Strategjisë për Komunitete dhe Kthim (2014-2018). Në mënyrë të veçantë, ky veprim do të synojë ngritjen e kapacitetit të akterëve qeveritarë në të gjitha nivelet dhe akterët jo shtetërorë për të lehtësuar kthimin dinjitoz, të qëndrueshëm dhe ri-integrimin në Kosovë e deri në 400 familjeve të zhvendosura në rajon, duke përfshirë familjet romë, ashkali dhe egjiptiane që aktualisht janë në vendbanime joformale dhe kampe në IRJM dhe në Mal të Zi. Gjatë hartimit dhe implementimit të projektit, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet nevojave të komunitetit RAE, me të paktën 40% të përfituesve që vijnë nga ky grup minoritar. Një qasje e veçantë do të përdoret me gratë RAE që janë ndër më të disfavorizuarat në Kosovë.
Objektivi:	OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM: Të kontribuojë në një shoqëri multietnike stabile në Kosovë duke mundësuar kushte jetësore të qëndrueshme dhe integrimin e qëndrueshëm në shoqërinë kosovare për të kthyerit, PZhr-të, PZhbV-të dhe refugjatët të cilët me vullnetin e tyre të lirë zgjedhin të kthehen në Kosovë. OBJEKTIVI SPECIFIK: Të ngritet kapaciteti i aktorëve qeveritarë në të gjitha nivelet dhe aktorëve jo-shtetërorë për të lehtësuar kthimin dinjitoz, të qëndrueshëm dhe ri-integrimin në Kosovë e deri në 400 familjeve të zhvendosura në rajon, duke përfshirë familjet RAE aktualisht në vendbanime joformale dhe kampe në ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Malin e Zi.
Aktorët kyç:	Ministria për Komunitete dhe Kthim (MCR), Zyrtarët komunal për komunitete dhe kthim (ZKKK), Grupet Punuese Komunale (GPK-të), organizatat lokale dhe ndërkombëtare, agjensionet e Kombeve të Bashkuara.
Rezultatet e vlerësuara:	Rezultati 1. Është shtuar kapaciteti i autoriteteve komunale në lidhje me implementimin e politikave, koordinimin, menaxhimin dhe monitorimin e çështjeve dhe projekteve të kthimit vullnetar dhe ri-integrimit Rezultati 2. Kthimi fizik i deri 400 familjeve të zhvendosura, në bazë të vendimit të lirë dhe të mirë-informuar, mundësohet përmes ndërtimit dhe riparimit të shtëpive dhe infrastrukturës përkatëse të komunitetit në vendet e kthimit. Rezultati 3. Qëndrueshmëria e ri-integrimit të familjeve të kthyerë e përmirësuar përmes ofrimit të mbështetjes së përshtatur socio-ekonomike dhe qasjes së shtuar në dokumentet e statusit social dhe në shërbimet qeveritare.
Grupet e synuara / përfituesit:	a) Stafit i MKK-së b) Zyrtarët pushtetit lokal – në veçanti në ZKKK c) Të kthyerit minoritarë (gra, burra, vajza dhe djem)
Agjensioni implementues:	IOM (Organizata Ndërkombëtare për Migracion) misioni në Kosovë